



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Histori e Rosisë

Ngarkesa: 4kredite; 40orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë ruse -Drejtimi: Përkthim dhe Interpretim

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Histori e Rosisë synon që të pajisë studentët me njohuritë dhe konceptet bazë mbi historinë e Rosisë. Studentët do të njihen me fakte historike dhe kulturore, që kanë shoqëruar popullin rus që nga krijimi i shtetit të parë e deri ne ditët e sotme. Duke filluar me njohuritë bazë mbi sllavët dhe ndarjen e tyre, për krijimin e shtetit të Kievskaya Rus me principatat e tij, në vazhdim me njohuritë mbi krijimin e perandorisë Ruse, me në krye Pjetrin e Madh. Duke e mbyllur me rënien e dinastisë së Romanovëve, krijimin e Bashkimit Sovietik dhe të Federatës Ruse.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të kuptojë dinamikën dhe rregulsinë e procesit historik, rolin e dhunës dhe jo-dhunës në histori, rolin e individit në procesin historik;
- 2.Të kuptojë, analizojë në mënyrë kritike dhe përdorur informacionet kryesore historike;
- 3.Të pranojë me tolerancë dallimet sociale, etnike-kombëtare, fetare dhe kulturore në shoqëri;

Rezultate të pritshme:

- 1.Të shpjegojë përmbajtjen e termave dhe koncepteve kyçe;
- 2.Të zgjerojë dhe të thellojë njohuritë mbi figurat historike;
- 3.Të përcaktojë dhe të shpjegojë qëndrimin e tij për ngjarjet dhe personalitetet më të rëndësishme
- 4.Të ushtrojë një mendim analitik, kritik, logjik dhe kreativ ne interpretimin e materialeve te ndryshme.
- 5.Të përzgjedhë dhe referojë bibliografi shkencore të mirëfilltë.
- 6.Të analizojë probleme dhe procese të rëndësishme shoqërore